



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA**

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____ 2019

Njoftim

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; te ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë.16.07.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 29.10.2019, ora 10:00** në sallën e Mbledhjeve të ERE-s do të zhvillohet mbledhja e radhës e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

- 1-** Mbi fillimin e procedurave për rishikimin e Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, të ndryshuar me Vendimin nr. 144, datë 25.06.2018 (Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve)
- 2-** Mbi kërkesën e shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike (Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve)
- 3-** Mbi fillimin e procedurës për liçencimin e shoqërisë “HP Panarit” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Vile” (Drejtoria e Liçencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes)
- 4-** Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Përparimi SK” , për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të Intesa SanPaolo Bank (Drejtoria e Liçencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes)
- 5-** Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hec Lashkiza” , për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të Intesa SanPaolo Bank (Drejtoria e Liçencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes)
- 6-** Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hec Kabash Poroçan” , për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të Intesa SanPaolo Bank (Drejtoria e Liçencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes)
- 7-** Mbi fillimin e procedurës për liçencimin e shoqërisë “Hec ARSTI”, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike (Drejtoria e Liçencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes)

8- Mbi rinovimin e liçencës së shoqërisë “Devoll Hydropower”, me nr. 274, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (Drejtoria e Liçencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes)

9- Çështje të brendshme të ERE-s

KRYETARI

Petrit AHMETI